

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës–Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sadik Kryeziu, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.K, nga fshati, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 147 par.1 nën par.9 të KPK, duke vendosur për ankesat e Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar av.N.P dhe të mbrojtësve të të akuzuarit A.K, av.A.R dhe av.Sh.P, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.8/2013, të datës 23.10.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, më datë 25.03.2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, përfaqësuesit të palës së dëmtuar dhe ato të mbrojtësve të të akuzuarit A.K, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.8/2013, të datës 23.10.2013, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, me aktgjykimin, PKR.nr.8/2013, të dt.23.10.2013, e ka shpallur fajtor të akuzuarin A.K, për veprën penale vrasje e rëndë, nga neni 147 par. 1 nën par.9 të KPK, dhe e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 17(shtatëmbëdhjetë)viteve, në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej 27.06.2009, e tutje. Të akuzuarin e ka detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës ndërsa në emër të shumës së paushallit gjyqësor, shumën prej 400(katërqind)€, të gjitha në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nga i akuzuari është konfiskuar arma-pushka e gjuetisë "Double barrel" e kal.16 mm, me numër serik 36481, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike i ka udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

- Prokuroria Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit, t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim.

-Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, av.N.P, për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit, t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim.

-Mbrojtësit e të akuzuarit A.K, av.A.R dhe av.Sh.P, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, i akuzuari A.K, të shpallet fajtor për vepër penale vrasje nga pakujdesia nga neni 149 të KPK, ose ta liroj nga akuza apo i njëjti të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rivendosje.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorin e Apelit, të dëmtuarit, të akuzuarin dhe mbrojtësit e tij. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm Prokurori i Apelit në Prishtinë-Xhevdet Bislimi, përfaqësuesi i palës së dëmtuar av.N.P, të dëmtuarit Q.Ldhe S.L, i akuzuari A.K, mbrojtësit e tij, av.A.R dhe Sh.P. Në seancën e kolegjit Prokurori i Apelit, Xhevdet Bislimi, ngeli në tërësi pranë pretendimeve ankimore, duke propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, të cilin po ashtu e përkrahu edhe përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av.N.P. Mbrojtësi i të akuzuarit, av.A.R, po ashtu ngeli pranë pretendimeve ankimore duke shtuar se prokurori është dashur të deklarohet edhe për motivin e vrasjes, gjë që nuk e ka bërë as edhe në ankesë dhe se në rastin konkret konstaton se pasi që kemi të bëjmë me vrasje nga pakujdesia, propozon që të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë, në kuptim të cilësimit juridik të veprës penale dhe kuptohet të akuzuarit, ti shqiptohet dënim më i butë, sesa dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa përkitazi me këtë av. Sh.P, thekson se sa i përket konstatimit, se mes dy familjeve ka pasur mosmarrëveshje të vazhdueshme, një gjë e tillë nuk qëndron, por vepra penale në fjalë është pasojë e moskujdesit. I akuzuari përkrahu pretendimet ankimore të mbrojtësve të tij, si dhe vërejtjet e paraqitura në këtë seancë.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPA/I.nr.135/14, të dt.25.02.2014, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, si dhe ajo e palës së dëmtuar të aprovohen, kurse ajo e mbrojtësve të të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara.

Mbrojtësit e të akuzuarit në ankesat e tyre, pretendojnë se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nën par.12 të KPPK, sepse sipas ankesës të mbrojtësve të të akuzuarit, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyerat e aktgjykimit, në të nuk janë paraqitur të gjitha faktet dhe rrethanat të cilat përbëjnë figurën e veprës penale, pastaj edhe ato arsye të paraqitura janë në kundërthënie ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave, pastaj se aktgjykimi nuk është përpiluar konformë dispozitave të nenit 370 të KPPK, nga se nuk janë paraqitur arsyerat për faktet e vërtetuara gjegjësisht faktet e pa vërtetuara, ngase në dispozitiv shënohet data dhe koha e saktë kur i akuzuari, së bashku me dëshmitarin E.B, kanë hyrë në pyll në fshatin Kotlinë, ndërsa në arsyetim përkitazi me këtë nuk është thënë asgjë edhe pse gjykata e shkallës së parë, i ka përshkruar deklaratat e dëshmitarëve nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë e duke paraqitur kështu edhe vlerësimet e veta. Pastaj pretendohet se në dispozitiv nuk bëhet fjalë fare për motivin i cili e shtyri të akuzuarin që të shkoj në vendin e ngjarjes, se si ata u pajisën me armë-pushkë gjuetie, pra i akuzuari dhe dëshmitari E.B, e sidomos se pse i akuzuari A.K, e mori pushkën e gjuetisë me vete-pra, për tu mbrojtur nga shtazët e egra, apo me qëllim që ta privoj nga jeta tani të ndjerin S.L. Po ashtu arsyetimit i mungojnë arsyerat për faktet vendimtare ngase gjykata e shkallës së parë, vetëm ka përshkruar deklaratën e dëshmitarit pa paraqitur arsyerat se pse i akuzuari hyri në pyll, së bashku me dëshmitarin, gjegjësisht se pse ata u ndanë në dy drejtime dhe se a e dinin ata pra, i akuzuari dhe dëshmitari se në pyll gjendej dhe tani i ndjeri S.L. Sipas pretendimeve ankimore në rastin konkret në këtë çështje penalo juridike, nuk është vërtetuar dashja dhe motivi ashtu sikur që është cekur në dispozitiv. Përkitazi me kontradiktoritetin e dispozitivit në arsyetimin, theksohet se edhe motivi i përshkruar në dispozitiv, ku konstatohet se është fjala për vrasje me dashje, nga hakmarrja e paskrupull, në një distancë prej 18m, ndërsa në arsyetim në faqen 10, pasusi katër thuhet “se i akuzuari A.K, me të ndjerin dhe familjen e tij kanë pasur rregullisht mosmarrëveshje para ndodhjes së rastit konkret”, e që nga arsyetimi në vijim pastaj konstatohet se “i akuzuari, ka pasur mosmarrëveshje me vllaun e tani të ndjerit “...”, pastaj kontradiktë tjetër është edhe kur në arsyetim në faqen 14, pasusi tre, thuhet: “se nga rikonstruksioni i vendit të ngjarjes vërtetohet se i akuzuari e ka ditur dhe e ka vërejtur kuartë tani të ndjerin, kur ka shtënë ndërsa në dispozitiv konstatohet “i akuzuari posa e vëren të vetmuar duke ecur rrugës së pyllit”.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e më sipër ankimore janë të pabazuara nga se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara nga neni 384 par.1 nën par.12 të KPPK, nga se dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, ngase në të është përfshirë koha e kryerjes së veprës penale, e edhe momenti kritik para ngjarjes kryesore-pra vrasjes së tani të ndjerit, pastaj ka fakte dhe rrethana të mjaftueshme edhe përkitazi me motivin e kryerjes së veprës penale.

Në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penale juridike, po ashtu, janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par.2 të KPPK, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par.7 të KPPK, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyerash i merr si të provuara ose si të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë këtu përveç motivit të kryerjes së veprës penale edhe dashjen e të akuzuarit, e konkretisht edhe qëllimin e të akuzuarit, që ta privoj nga jeta tani të ndjerin S.L, dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Qasja ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme as një fakt nuk ka ngelur dubioz ose i pavërtetuar dhe përveç që janë vërtetuar drejtë ato edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, motivin, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe po ashtu përkitazi me dashje, por edhe motivin e kryerjes së veprës penale, pastaj është marr parasysh mbrojtja e të akuzuarit, se vrasjen e ka kryer nga pakujdesia, për çka përkitazi me këtë ka dhënë arsye të mjaftueshme duke bërë të qartë se i akuzuari ditën kritike ka qenë plotësisht i vetëdijshëm se në pyll gjendet edhe tani i ndjeri S.L, dhe se në momentin kritik para se ta qëllonte po ashtu ka konstatuar se e ka vërejtur mirë se është fjala për tani të ndjerin, e jo ndonjë shtazë apo diçka “e zezë”, sikur që pretendon i akuzuari. Po ashtu pastaj ka dhënë arsye të mjaftueshme edhe për motivin, duke përshkruar raportet jo të mira familjare në mes familjes së të akuzuarit dhe asaj tani të ndjerit dhe se nuk mund të flitet për kontradiktë në këtë aspekt, sikur që pretendohet në ankesë ngase nuk do të thotë se raportet të kenë qenë jo të mira, pikërisht vetëm në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerit, por sikur që konstatohet drejtpërdrejt me vëllan e tani të ndjerit dhe pikërisht për këtë bëhet fjalë për hakmarrje të paskrupullt, për çka në detaje është elaboruar në arsyetimin e aktgjykimit të

shkallës së parë. Gjithashtu, janë dhënë arsyerat të mjaftueshme për veprimet inkriminuese të të akuzuarit që përbëjnë elementet qenësore të veprës penale në fjalë, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike me ankesë në esencë kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nga ana e gjykatës së shkallës së parë, si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë në bazë të provave të administruara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, prandaj edhe përfundimet kanë pasuar të gabuara, pa mbështetje në prova, për çka të akuzuarin, është dashur ta shpall fajtor për veprën penale të vrasjes nga pakujdesia, e jo sikur që është vepruar nga gjykata e shkallës së parë. Përkitazi me këtë bazë ankimore sidomos pretendohet se gabimisht është vërtetuar gjendja faktike, kur gjykata nuk ka vlerësuar realisht ekspertizën mjeko ligjore dhe atë të balistikës, pastaj raportin e rekonstrukcionit të vendit të ngjarjes dhe deklaratën e dëshmitarit E.B, për çka pastaj gabimisht ka zbatuar edhe dispozitat e Ligjit Penal, kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 147 par.1 nën par.9 të KPK.

Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë nga këto arsye.

Në këtë çështje penalo-juridike nuk janë kontestuese rrethanat përkitazi me vendin ku është kryer vepra penale, veprimet e ndërmarra nga i akuzuari, mënyra dhe vendi ku janë shkaktuar lëndimet trupore të tani të ndjerit, e si rezultat i të cilave ka ardhur edhe te vdekja e tani të ndjerit, por kontestuese ngelin në rastin konkret rrethanat përkitazi me elementin subjektiv të veprës penale, pra lidhur me dashjen e të akuzuarit, duke potencuar se i akuzuari, nuk ka pasur dashje, gjegjësisht qëllimin që të privoj nga jeta tani të ndjerin, por se i njëjti ka ndërmarrë veprimet inkriminuese nga pakujdesia, gjegjësisht i vënë në lajthim faktik, ngase ka menduar se është duke shtënë me armë zjarri në shtazë të egra, e jo në njeri, e aq më pakë në tani të ndjerin S.L.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore përkitazi me këtë bazë ankimore, po ashtu nuk qëndrojnë ngase në bazë të provave të prezantuara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, por edhe vetë mbrojtjes së të akuzuarit, vërtetohet se ditën kritike i akuzuari, kishte dalë nga shtëpia e tij, duke nxjerrë kështu bagëtinë për kullosë dhe me vete kishte marrë zagarët dhe pushkën e gjuetisë, ku në vendin e quajtur "...", me telefon e ka ftuar edhe dëshmitarin E.B, ku pasi qëndrojnë disa qaste në bisedë e sipër kanë dëgjuar të lehura të zagarëve, ku pastaj nisen në drejtim të tyre, ashtu që dëshmitari shkon në drejtim të majtë, kurse i akuzuari në drejtim të djathtë dhe me të arritur në vendin e quajtur "...", kur vëren një pikë të zezë "diçka të zi", e duke menduar se është fjala për ari apo derr të egër, gjithherë pra, sipas pretendimit të të akuzuarit, i akuzuari ka shtënë me pushkë gjuetie dhe pasi ka dëgjuar një zë njeriu duke thënë "of", të cilin pastaj e pyet "se a të rroku" dhe nga përgjigjja

që ka marrur ka kuptuar se është fjala për tani të ndjerin S.L. Ndërsa në bazë të deklaratës së dëshmitarit E.B, deklaratë e cila kjo përputhet edhe me mbrojtjen e të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se pasi dëshmitari dhe i akuzuari kanë dëgjuar të lehurat e zagajve, kanë shkuar në drejtime të kundërta dhe duke ecur për një çast dëshmitari ka dëgjuar të shtëna nga arma e gjuetisë, pastaj zërin e të akuzuarit, duke thënë "...", por edhe zërin e tani të ndjerit S.L, kur ka thënë "valla bajagi", dhe pastaj dëshmitari menjëherë ka shkuar në drejtim të zërit të tani të ndjerit, ku pastaj të njëjtin e gjen duke ecur i plagosur dhe pasi nis ta ndihmojë, e vëren se i njëjti ishte i plagosur në anën e djathtë të trupit, ku edhe për një moment-tani i ndjeri është rrëzuar për toke dhe në atë moment arrin edhe i akuzuari, e pastaj pas pakë çastesh edhe dëshmitari V.L. Në bazë të deklaratës të dëshmitarit në fjalë, po ashtu gjykata ka vërtetuar se derisa i akuzuari dhe dëshmitari E.B, po qëndron tek vendi i quajtur "...", ku kanë dëgjuar zërin, gjegjësisht të lehurat e zagarit, të njëjtit e kanë ditur se është fjala për zagarin e tani të ndjerit S.L dhe gjithnjë sipas deklaratës së dëshmitarit në fjalë, edhe i akuzuari edhe dëshmitari e kanë ditur se në pyll është tani i ndjeri S.L, që do të thotë se pa mëdyshje është vërtetuar se i akuzuari, e ka ditur se në pyll gjendet tani i ndjeri S.L, e duke marrë parasysh edhe raportin e rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, ku është konstatuar se vendi ku ka ndodhur rasti është rrugë pylli, në gjerësi prej 2-3m, e gjatësi prej 60m, me drunj anash, e me pamje të mirë në lartësi-gjatësi prej 60m, atëherë rrjedh se i akuzuari ditën kritike me dashje direkte ka qëlluar në tani të ndjerin S.L, e me qëllim që të njëjtin ta privoj nga jeta, e jo duke menduar se është fjala për shtazë të egra. Përkitazi me faktet në fjalë, gjykata e shkallës së parë, përmes rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, po ashtu ka vërtetuar edhe largësinë, gjegjësisht distancën në mes vendit ku është qëlluar tani i ndjeri dhe vendit ku ka qëndruar i akuzuari, ku ka shtënë në tani të ndjerin dhe kjo distancë është vërtetuar se ka qenë 18m, por duke pasur parasysh edhe konkludimet ekspertizës mjeko ligjore dhe asaj të balistikës, ku është vërtetuar natyra dhe lloji i plagëve të shkaktuara e në bazë të ekspertizës së balistikës edhe pozita e të akuzuarit dhe tani të ndjerit në momentin e goditjes me pushkë gjuetie, por edhe vetë deklaratës së të akuzuarit, i cili përkundër ekspertizave në fjalë, por edhe rikonstruksionit në vendin e ngjarjes në bazë të deklaratave të dëshmitarëve, e sidomos të provave materiale-para, njollave të gjakut, gëzhrojave të gjetura në vendin e ngjarjes prapëseprapë-para, i akuzuari tenton ta ndryshoj krejtësisht pozitën dhe vendqëndrimin e tij, në momentin kritik-para, kur ka shtënë në tani të ndjerin, kuptohet gjatë procesit të rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, me pa mëdyshje është vërtetuar se i akuzuari me dashje direkte ka shtënë në tani të ndjerin, e me qëllim që ta privoj nga jeta e për shkak të hakmarrjes së paskrupullt.

Ndërsa, përkitazi me faktet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me motivin e vrasjes, gjykata e shkallës së parë nga dëshmitari S.L, ka vërtetuar se raportet në mes familjes së të akuzuarit dhe tani të ndjerit, kanë qenë gjithmonë raporte jo të mira, gjegjësisht me grindje të përhershme dhe atë për shkak të përdorimit të ujit për ujitje, ku shpeshherë ka ardhur edhe deri te rrahja në mes këtyre dy familjeve, e që e fundit ka ndodhur në mes vëllait të tani të ndjerit dhe vetë të

akuzuarit, ku pastaj edhe përkundër tentimit të pajtimit të tyre, për shkak të ngacmimeve të përhershme ka pasur edhe rrahje tjera në mes këtyre dy familjeve, ku më vonë po ashtu nga i akuzuari është rrahur edhe axha i dëshmitarit Q, fakte këto që i vërteton edhe dëshmitari tjetër O.L. Ndërsa nga deklarata e dëshmitarit H.B dhe V.B, përveç që vërtetohen faktet e njëjta sikurse nga dëshmitarët S.L e O.L, ata vërtetojnë po ashtu se i akuzuari, përveç që është rrahur me anëtarët e familjes L, disa herë për probleme të përhershme në mes tyre, rreth shfrytëzimit të ujit, vërtetohen edhe faktet se i njëjti ka deklaruar dhe se “do ta vras një djalë të I.L,” – është fjala për babain e tani të ndjerit S.L, fakte këto që i vërtetojnë edhe dëshmitarët tjerë në këtë çështje penale-juridike dhe atë deklaratat në fjalë-pra gjithëherë sipas dëshmitarëve janë theksuar pak kohë para ditës kritike, kur edhe ka ndodhur vrasja e tani të ndjerit S.L.

Prandaj, duke i pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, në të cilat është zhvilluar ngjarja kritike, rrethanat se i akuzuari, e ka ditur se tani i ndjeri gjendet në pyll dhe aty afër, pastaj vendin nga i cili ka shtënë i akuzuari, pra, vend me pamje të mirë dhe atë me gjatësi prej 60m, e rrugë me drunj anash dhe atë në një largësi prej 18m, nga tani i ndjeri S.L, e duke marrë parasysh raportet jo të mira familjare dhe atë në mënyrë të përhershme, e sidomos rrethanën se herën e fundit të akuzuarin gjatë një loje e ka rrahur vëllau i tani të ndjerit dhe faktin se tani të ndjerin me pushkë gjuetie që e kishte me vete e qëllon dhe atë në pjesë vitale të trupit, ku plagët ishin të rrezikshme për jetë, rezulton se tek i akuzuari, qëndron elementi subjektiv i veprës penale, për të cilën është shpallur fajtor, pra qëndron fakti se i njëjti veprimet konkrete inkriminuese i ka ndërmarrë me dashje dhe atë me dashje direkte - pra, për ta privuar nga jeta tani të ndjerin. Kështu që arsyet më të detajuara të dhëna në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, në tërësi si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë, ngase të njëjtat kanë mbështetje në provat e prezantuara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, për çka po ashtu aktgjykimi i ankimuar përmban edhe arsye të mjaftueshme mbi të gjitha faktet vendimtare dhe në bazë të një gjendje të tillë faktike të vërtetuar rezulton se në mënyrë të drejtë janë aplikuar edhe dispozitat e ligjit penal. Prandaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, rrethanat në të cilat është zhvilluar ngjarja kritike, arsyet të cilat i ka dhënë gjykata e shkallës së parë, rezulton në mënyrë të qartë se është i drejtë konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se në veprimet inkriminuese të të akuzuarit, përmbushen të gjitha tiparet e veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 147 par.1 nën par.9 të KPK.

Duke e shqyrtuar çështjen përkritazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, si dhe ato të mbrojtësve të të akuzuarit, nuk janë të bazuara.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda, përkritazi me këtë bazë ankimore theksohet se gjykata e shkallës së parë, rrethanat lehtësuese të cilat i ka konstatuar nuk i ka vlerësuar drejt, por

përkundrazi të njëjtat i ka mbivlerësuar. Konsideron se mënyra e kryerjes së veprës penale, ku vrasje e tani të ndjerit S.L, është kryer për shkak të hakmarrjes, pastaj shkalla e lartë e dashjes e duke marrë parasysht se në rastin konkret kanë mbetur tre fëmijë pa baba, e në përkujdesjen e të ëmës, janë të gjitha këto rrethana të cilat ndikojnë në shqiptimin e një dënimi më të ashpër, ndërsa sipas palës së dëmtuar, dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, nuk është në përputhje me peshën e veprës penale, rrethanat lehtësuese janë mbi vlerësuar, ngase fakti se i akuzuari, nuk është i dënuar më parë, nuk mund të merren si rrethana lehtësuese dhe shton se nuk janë marrë parasysht rrethanat tjera rënduese. Mbrojtësi i të akuzuarit, av.A.R, në ankesë përkitazi me këtë bazë ankimore konstaton se pasi që aktgjykimi i ankimuar është i kundërligjshëm atëherë logjikisht rezulton se edhe vendimi për dënim nuk është i drejtë, për çka propozon që i akuzuari të shpallet fajtor për veprën penale të vrasjes nga pakujdesia dhe pastaj për këtë vepër penale të shqiptohet edhe dënimi adekuat, pa cekur arsyet tjera konkrete, ndërsa mbrojtësi tjetër av.Sh.P, thekson se përkundër vërejtjeve të cekura si më lartë, nëse Gjykata e Apelit, konstaton se kemi të bëjmë me vrasje si në dispozitiv, atëherë ka edhe rrethana tjera lehtësuese në anën e të akuzuarit, sikur që janë se i njëjti është i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, është penduar, për çka se edhe konsideron se ka vend edhe për shqiptimin e dënimit shumë më të butë.

Në ankesa të ushtruara nuk prezantohet ndonjë rrethanë tjetër rënduese apo lehtësuese të cilat kishin me pasur ndikim të drejtpërdrejt në lartësinë e dënimit, prandaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejt dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit siç parasheh dispozita e nenit 73 të KPK, ngase në rastin konkret edhe rrethanat lehtësuese të vlerësuar si pendimi, se nuk është i dënuar më parë etj, janë të pranueshme për këtë gjykatë, ndërsa rrethanat rënduese të cekura në ankesë shumicën prej tyre i ka pasur parasysht edhe gjykata e shkallës së parë, e disa nga ato veç janë elemente përbërëse të veprës penale, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Prandaj, duke pasur parasysht të gjitha këto rrethana, rrethanat e cekura në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, mënyrën si është zhvilluar ngjarja ditën kritike, pastaj shkaktimin e pasojës së ndaluar, rezulton se dënimi i shqiptuar të akuzuarit, është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, po ashtu i njëjti është në funksion të preventivës gjenerale, por edhe asaj individuale dhe se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitat e nenit 41 të KPK.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, aktgjykimin e shkallës së parë, e kundërshton edhe përkitazi me vendimin për kërkesë pasurore juridike, duke theksuar se pasi që kërkesa në fjalë nuk është aprovuar, është dashur që gjykata e shkallës së parë, të urdhërojë Fondin për Kompensimin e viktimave,

që të dëmtuarve tu kompensohet kërkesa pasurore-juridike, mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore edhe përkitazi me këtë bazë janë të pabazuara.

Me dispozitat e nenit 62 par. 5 të KPPK-së, shprehimisht parashihet që në rastet kur gjykata nuk mund të urdhërojë kompensimin për shkak të pamundësisë së të pandehurit për të paguar, atëherë nëse i dëmtuari kërkon gjykata ka mundësi që urdhrin në fjalë ta dërgojë tek Fondi për Kompensimin e Viktimave, gjë që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, nuk ka vendosur për kërkesën pasurore-juridike, por të dëmtuarit i ka udhëzuar në kontest civil, kështu që vetëm pasi që të vendos për kërkesën në fjalë e nëse plotësohen kushtet e cekura si më lartë, atëherë të dëmtuarit mund të kërkojnë që vendimi i gjykatës përkitazi me kërkesën pasurore-juridike, ti dërgohet Fondit për Kompensimin e Viktimave, ndërsa në rastin konkret duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e kërkesës në fjalë, gjykata me të drejtë, bazuar në dispozitat e nenit 463 par.2 të KPPK, të dëmtuarit i ka udhëzuar që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest të rregullt civil.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.123/2014, me dt.25.03.2014

Procesmbajtës,
Sadik Kryeziu

Anëtarët e kolegjit,

Kryetari i kolegjit,
Fillim Skoro

1. Xhevdet Abazi

2. Abdullah Ahmeti